



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.856/2 prot:

Pukë, më 26.04.2024

VENDIM

Nr 15 date 23.04.2024

PËR:

MIRATIMIN PËR KORRIGJIMIN E KUFIRIT KADASTRAL MIDIS FSHATRAVE  
QELEZ, DUZHNEZ DHE BUSHAT

Këshilli i Bashkisë Pukë në mbledhjen e tij të rradhës të dates 23.04.2024, bazuar në piken 4 të nenit 55, germa (c) e nenit 64 si dhe neni 93 i Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Neni 16, 35 të Ligjit 111/2018 “Per Kadastrën”, si dhe shkresës së Zyrës Vendore ASHK-Pukë, me Nr. 14/1 Prot, datë 16.01.2024, e cila ka kërkuar bashkëpunimin me Bashkinë Pukë për të bërë të mundur ndryshimin e kufirit Kadastral ndërmjet Zonave Kadastrale me Nr. 3092 (fshati Qelez), ZK Nr.1586 (fshati Duzhnez), ZK1330 (fshati Bushat), me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

Këshilli Bashkiak pas shqyrtimit të dokumentacionit:

VENDOSI:

1. Të miratojë kufirin kadastral sipas saktësisimit dhe korrigjimit ndërmjet fshatrave Qelez, Duzhnez, Bushat, sipas hartës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Zyra e Bujqësisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
4. Shpallur me datë 26.04.2024
5. Miratuar me 9 vota; Vota Pro 9 , Vota Kundër 0, Vota Abstenim 0

SEKRETARE

Edona HYSENAJ

1/2024

KRYETARI I KESHILLI

Eduard GJOKA



09.05.2024  
F. Hyqari  
[Signature]

856/24  
09.05.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Shkodër, më 07.05.2024

Nr.856/3prot.

**LËNDA:** Mbi vendimin Nr.15, datë 23.04.2024 të Këshillit Bashkiak Pukë.

**KËSHILLI BASHKIAK PUKË**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, gërma a, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 64/c, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksi 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", Kreu III, neni 4, ligjit Nr.115/2014 "Për ndarjen administrative territoriale të njesive të qeverisjes vendore në RSH" i ndryshuar, ligjit Nr.111/2018 "Për kadastrën", VKM Nr.28 datë. 27.01.2023 "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditesimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve", materialit të dërguar nga Sekretarja e Këshillit Bashkiak Pukë "Procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Pukë Nr.911.prot, datë 23.04.2024", shqyrtoi **VKB Pukë Nr.15 datë 23.04.2024** "Mbi miratimin e korigjimit të kufirit kadastral midis fshatrave Qelëz, Duzhnez dhe Bushat".

Pas trajtimit konstatohet si vijon:

Sipas të dhënave është e paqartë situata ligjore, nëse kemi të bëjmë me tjetërsim prone sipas nenit 54/e e ligjit Nr.139/2015, apo kemi të bëjmë me nenin 93 të ligjit Nr.139/2015, apo kemi të bëjmë me nenin 16 të ligjit Nr.111/2018 "Për Kadastrën" (rast i cili nuk kërkon vendimarrje të këshillit bashkiak),

Duhët të saktësohet nëse nevojiten të respektohet neni 18 i ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, mbi seancat e konsultimit,

Për sqarim të situatës është e domosdoshme dokumentacioni ndërmjet Bashkisë Pukë dhe ASHK Pukë.

Për sa trajtuar, mbetemi në pritje të saktësimeve, plotësimit të materialit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**

